



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/03-7800//22
Kaçanik, 18.03.2022

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e III (Tretë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës ,në sallën e komiteteve të KK, me 24 Mars 2022 (e Enjte) më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e III-të (Tretë) të Rregullt të KPF-s të datës, 24.03.2022, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Rregullore për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës;
3. Propozim Rregullore për ndryshim plotësimin e rregullores 01Nr. 346-18740/2013 të datës 29.07.2013- për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve;
4. Propozim Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike ‘Pastërtia’ SH.A. Njësia Kaçanik;
5. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës 2022;
6. Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e auditimit të vitit 2021, nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
7. Raporti i punës i Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19, në komunën e Kaçanikut;
8. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2022;
9. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0;
10. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Ivajë, parcela me nr. 585-2;
11. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Ivajë, parcela me nr. 704-2;
12. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Kovaçec, parcela me nr. 174-0;
13. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private, parcelat me nr. 1244-0 1247-0, 1248-0, 1251-0, 1252-0, 1257-0, 1258-0, 1300-0,1260-0, 1259-0, 1254-0, 1256-0, 1253-0, 1250-0, 1249-0, 1246-0 1245-0 ZK Begracë;
14. Propozim Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, parcela kadastrale nr. 568-1, ZK Kaçanik ;
15. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit nga kultura varreza në tokë ndërtimore, parcelat kadastrale nr.00007- dhe 00090-2 ZK Kaçanik;
16. Propozim Vendim për ndryshimin e trasesë rrugore në parcelat kadastrale nr. 1579-2, 1579-3 dhe 3126-0 ZK Begracë;
17. Propozim Vendim për emërimin e anëtarëve te komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60//01-4548/22
Kaçanik, 23.02.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II-të (Dytë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 23 Shkurt 2022. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF, ishin të gjithë anëtarët dhe atë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani dhe Rabiye Sallahi

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i komunës-Besim Ilazi, Nënkrjetari i komunës-Sabedin Vishi, drejtorët e drejtorive: Qamil Stagova, Ramadush Osmani, Sali Malsiu, Bahri Selimi, Pranvera Loku-Zharku dhe Suhad Dullovi, ndërkaq nga zyrtarët ishte Fatlume Selimi dhe Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit.
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, pasi konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e II-të të Rregullt të KPF-a për vitin 2022, data 23 Shkurt me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021;
3. Informatë e Zyrës së Personelit për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2021;
4. Raporti Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2021;
5. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH. A – Njësia Kaçanik;
6. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit Komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve” SH. A- Kaçanik;
7. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00433-0 ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00453-0 ZK Duraj;
8. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00139-2 ZK Biçec, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00162-0, ZK Biçec;
9. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, parcelat kadastrale me numrat: 01306-2 dhe 01306-8, ZK Kaçanik i Vjetër, për shfrytëzimin e hapësirave shkollore;
10. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin 2021.

Kryesuesi i kuvendit: Lidhur me rendin e propozuar të punës e hapi diskutimi:

z. Agim Mani: Përshëndetje për të gjithë, materiali për pikën 10 nuk e kemi marrë, ndërkaq pika 11 nuk ka hyrë fare në rend pune të mbledhjes së KPF.

Kryesuesi i Kuvendit: Materiali për pikën 10 është dërguar, por nuk ka qenë i listuar, për këtë arsye sektori i KK e ka dërguar edhe një herë materialin, ndërkaq pika 11 -Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022, nuk shkon përmes procedurës së KPF, sepse komitetet janë në të njëjtin nivel, kështu që plani i këtij komiteti shkon vetëm në KK. Në vazhdim Kryesuesi i pyeti anëtarët tjerë se a iu ka ardhur Raporti i auditimit të brendshëm për vitin 2022 ? Përgjigja e tyre ishte po. Atëherë kryesuesi i KK kërkoj që t'i dërgohet raporti vetëm Agim Mani, në mënyrë që të ketë për mbledhje të KK. Nëse iu ka ardhur materiali me ftesën e KK, atëherë nuk ka nevojë për dërgim të materiali përsëri.

znj. Ardita Rrahmani: Mua emaili zyrtar nuk me funksionon, ndërkaq në emailin privat nuk me kanë ardhur materiali i mbledhjes.

Nga Sekretaria e KK iu bë me dije anëtarëve të KPF së materiali është dërguar në emaile zyrtare dhe ato private.

Kryetari i Komunës: Është mirë me ua dërguar edhe një herë atyre anëtarëve që nuk e kanë marrë materialin, në mënyrë që ta kenë për mbledhje të KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë diskutime të tjera nuk ka, rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 10 pikëve.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, a ka kush ndonjë vërejtje në procesverbal?: Meqenëse nuk ka kush ndonjë vërejtje, atëherë procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KPF e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së I-r (parë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 25.01.2022 / Lënda: 01Nr. 60//01-1863/22.

U kalua në shqyrtimin e pikave tjera sipas rendit të punës;

2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: Në këtë raport pune është përmbledhur aktiviteti i ekzekutivit të komunës për vitin 2021. Për ata që janë anëtarë të rinj, po ua njoftoj se ekzekutivi i komunës bënë dy raporte në çdo fund viti; raportin e përgjithshëm të ekzekutivit të komunës dhe raportin financiar. Materialin e keni marrë, kryetari dhe drejtorët janë prezent në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që ky raport pune t'i shkoj KK për diskutim. Të gjithë njëzëri u pajtuan që raporti t'i përcillet KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së

KPF, E diskutoj Raportin e Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021 dhe të njëjtin ia procedon Kuvendit të Komunës për diskutim.

3. Informatë e Zyrës së Personelit për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: Zyra e personelit është një organ që funksionon në kuadër të zyrës së kryetarit të komunës, e cila merret me menaxhimin e burimeve njerëzore. Më herët raporti ka hyrë në kuadër të raportit të kryetarit të komunës, tani po kërkohet me qenë i ndarë. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Kur jemi të sektori i arsimit, nëse një konkurs anulohet, sa dëmtohet buxheti i komunës apo buxheti i drejtorisë së arsimit ?

Kryetari i Komunës: Nëse anulohet konkursi, përsëritet përsëri në faqen zyrtare të komunës. Konkursi nuk publikohet më në gazetë, d.m.th. nuk ka kosto. Ajo që dëmtohem është se nganjëherë në mungesë të stafit arsimor, dëmtohen nxënësit për mbajtjen e orëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit që kjo pikë t’i adresohet KK për diskutim ? Rezultati i votimit është njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e diskutoj Informatën e Zyrës së Personelit për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2021 dhe të njëjtin ia procedon Kuvendit të Komunës në procedurë për diskutim.

4. Raporti Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: Në këtë pikë janë shtjelluar pasqyrat financiare të parasë publike gjatë vitit 2021. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Unë nuk mundem me diskutuar në këtë pikë, për shkak se nuk e kam marrë materialin. Unë kam probleme me emailin zyrtar se nuk me japin qasje. Kam kërkuar nga ministria, por ende nuk ma kanë lejuar qasjen.

Kryesuesi i Kuvendit: Ju si duket Ardita keni probleme teknike me emailin zyrtar. Në email zyrtar dërgohen materialet me lehtë, sepse kanë hapësirë më të madhe të dërgimit. Nëse të ka ardhur ftesa dhe e sheh se nuk të kanë ardhur pikët sipas ftesës, atëherë kontaktoj zyrtaret që merren me punë të KK.

z. Agim Mani, Kërkoj sqarim të shpenzimet për ndërtimin e shtëpive, të ndara nga 500€ për secilin rast.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Unë e kam një praktikë që nga viti 2012 që çdo shoqatë, çdo grup i qytetarëve vullnetar që i ndihmon njerëzit, do të bëhem solidar me i subvencionuar nga buxheti i zyrës. Për çdo shtëpi që ka ndërtuar qoftë “Feniksi” apo OJQ si “Jetimat e Ballkanit” që janë organizuar me ndërtuar shtëpi, jemi munduar me iu dalë në ndihmë në shumën nga 500 €.

z. Agim Mani: A hynë këtu edhe rasteve sociale ?

Kryetari i Komunës: Çështja e ndihmës së çastit është diçka tjetër. Për shtëpi banimi ndihmohen edhe rastet sociale, por ne nuk marrim për sipër subvencionime pa pasur organizime nga dikush

për ndërtimin e shtëpive. Nëse fjala vjen, ju organizoheni për dike me i ndërtuar shtëpi që është rast social, e bënë kërkesën komunës në emër të personit, me subvencionuar dhe ne e ndihmojmë. Çdokujt që ka organizuar aktivitete të tilla, iu kemi ndihmuar me nga 500€ me subvencione secilin rast deri me tani, sa kemi pasur mundësi financiare.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse organizohen kompanitë me ndihmuar një qytetar, komuna merr pjesë në participim, se nuk është mirë komuna me ndenjur indiferent.

z. Agim Mani : Mua me interesoj së është edhe organizata për efikasitet, që ka kërkuar me subvencionuar, por komuna nuk ka participuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Ajo është diçka tjetër, së komuna participin vetëm për kushte të banimit, e jo edhe për izolim të shtëpive. Komuna jep edhe ndihma çasti, për barna etj., por jo për izolime të shtëpive.

Kryetari i Komunës: Veç për kushte të banimit komuna participon me mjete. Ne kemi qenë në marrëveshje me atë organizatë, por nuk kemi mundur me përballuar atë kosto, se ne kemi menduar për 3.000€, ndërsa ajo ka kërkuar shumën 7.000-8.000 €, ka llogaritë me ia kryer krejt komuna e jo participim me 20%. Ne kemi menduar me i ndihmuar njerëzit të cilët nuk kanë kulm mbi kokë.

z. Qamil Stagova: Nëse dikush nga OJQ ndërton shtëpi banimi për familjet në nevojë, komuna participon me mjete buxhetore.

z. Kadri Krivenjeva: Këtu duhet ndarë disa gjëra të ndërtimi i shtëpisë. Duhet me u ndarë rastet sociale prej ndihmave humanitare. Nëse participohet në ndërtimin e shtëpisë, është krejt në rregull, ndërsaq izolimi i shtëpive kujtoj është llukës.

z. Agim Mani: Kriteri i parë me iu ndihmuar janë rastet sociale. Edhe të organizata për efikasitet është dashur me participuar komuna me 10 apo 15 %, së kanë izoluar shtëpi banimi të rasteve sociale.

z. Ramadush Osmani, Unë jam me në ngjarje lidhur me këtë çështje. Ka ardhur MSS përmes memorandumit të mirëkuptimit dhe ka kërkuar me iu ndihmuar për efikasitet të shtëpive të banimit. U kanë një formë e aplikimit. Kanë aplikuar qytetarët dhe janë përzgjedhur disa familje nga rastet sociale. Komuna u zotua që do të investoj në vlerën që e përcakton komisioni. Komisioni i ka vizituar 4 shtëpi, dhe e ka vlerësuar një shtëpi që ne vlerësojmë për participim 2.000€, ndërsa ata e kanë vlerësuar 7.000€. Kur e kemi llogaritur participimin, shuma ka dalë e madhe. Është fondacion që i rrisin çmimet. Memorandumi i mirëkuptimit nuk është në leverdi të komunës, participimi është i pa përballueshëm, sepse përfiton si fondacion me çmime të cilat janë shumë të larta.

znj. Rabije Sallahi : Është e panevojshme që komuna me participuar për izolim të shtëpive. Komuna duhet të participoj për familje në nevojë, që janë pa shtëpi banimi.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni t'i shkoj KK ky raport financiar. Për ish-in 6 anëtarë, kundër votë nuk ka, abstenoj Ardita Rrahmani, për faktin se nuk e kishte marrë materialin. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e **diskutoj Raportin Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2021 dhe të njëjtin ia procedon Kuvendit të Komunës në procedurë për diskutim.**

5. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH. A – Njësia Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, KRM “Pastërtia” Komuna e Kaçanikut është aksionare dhe në secilin mandat KK e formon komisionin e aksionarëve në bashkëpunim me kryetarin, të cilët e mbikëqyrin punën e bordit të asaj ndërmarrje. Drejtori i DSHPE është këtu për me na dhënë sqarime të nevojshme. Emrat epën në KK, 2 anëtarë do të jenë nga KK dhe 1 anëtar nga ekzekutivi i komunës. Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Parashtoj pyetje së në bazë të cilave kritere përzgjidhen anëtarët nga kuvendi në këtë komision?

Kryesuesi i Kuvendit: Të secili komision, shkohet me përfaqësim të subjekteve me të mëdha politike të përfaqësuara në KK. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t’i shkoj KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, e

Aprovoj

Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH. A – Njësia Kaçanik; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

z. Agim Mani, Kërkoj të di se a votohet në KK, Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021, Raporti financiar për vitin 2021 dhe Informata e Zyrës së personelit për vitin 2021 ?

Kryesuesi i Kuvendit, Jo nuk votohen në kuvend asnjëri raport. KK i adresohen sa për njoftim. Këto janë informata, më herët janë votuar, por nuk ka pasur kurrfarë efekti votimi i tyre.

6. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit Komunal të aksionarëve për NKP “ Stacioni i Autobusëve” SH. A- Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe të ky Propozim Vendim duhet të formohet komisioni i aksionarëve në përbërje prej tre anëtarëve, 2 anëtarë nga KK, 1 anëtar nga Ekzekutivi i komunës. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë propozim vendim dhe i njëjti u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, e

Aprovoj

Propozim Vendimin për themelimin e Komisionit Komunal të aksionarëve për NKP “ Stacioni i Autobusëve” SH. A- Kaçanik dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

z. Ramadush Osmani, Më herë KK ka formuar komision edhe për NP “ Bifurkacioni, mirëpo menaxhimi i ujërave ka kaluar në nivel të ministrisë, kështu që nuk e formojmë më atë komision.

7. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00433-0 ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00453-0 ZK Duraj;

Kryesuesi i Kuvendit: Pronat private shpallen me interes të përgjithshëm publik kur janë në interes të komunës, drejtori është prezent këtu, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Nëse ka mundësi drejtori me na dhënë sqarime më të hollësishme për pronën e cila shpallet me interes të përgjithshëm publik.

z. Qamil Stagova: Sqaroj së për zgjerimin e rrugës në f. Duraj, është marrë pronë private e pronarit në fjalë, dhe tani janë iniciuar procedurat për çështjen e shpronësimit të asaj prone. Shpronësimi bëhet me këmbim të pronës komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Bëhet fjalë për një pronë me sipërfaqe të vogla, është potencuar edhe me metra për pronat të cilat këmbehen.

z. Kadri Krivenjeva: Për hera tjera me na ofruar skica së ku gjinden ato prona , d.m.th. të bëhet edhe me ortofoto të gjeoportalit, se ne po shohim vetëm numra, ndërkaq nuk po i dimë se ku gjinden këto prona. Nëse i bashkëngjiten lëndës ortofotot, atëherë bëhet me e qartë se ku gjinden këto prona.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja është e qartë, lëndës iu kanë bashkëngjitur skica, fleta poseduese, skica e kopjes së planit e hijezuar e pronës private dhe asaj komunale që këmbehen. Nëse donë detaje tjera, atëherë mundesh me kërkuar në gjeoportali.

z. Kadri Krivenjeva: Ju ndoshta i keni të qarta se i dini pronat që këmbehen, ndërkaq për mua nuk janë shumë të qarta. Po t'i kishim ortofotot e gjeoportalit, do të kuptonim me mirë së cilat prona këmbehen.

z. Agim Mani: Kërkesa është e qytetarit i cili ka interes me këmbyer pronën e tij me pronën komunale. Lidhur me këtë çështje kërkoj sqarime me të detajuara.

Kryesuesi i Kuvendit, Me rregulla është ashtu, kërkesa bëhet nga qytetari, pastaj komuna e shikon interesin e saj.

Kryetari i Komunës, Drejtori është prezent në mbledhje për me dhënë sqarime të nevojshme. Çështja është shumë e qartë në propozim vendim. Është shënuar sipërfaqja sa jep komuna dhe sa merr. Rruga është publike, ne ose duhet me bërë këmbim me pronën komunale ose pala e procedon lëndën në gjyq. Aq sa marrim pronë aq edhe japim sipas këtij propozim vendim. Ne e kemi menduar se kjo formë e kompensimit është më e mirë.

z. Kadri Krivenjeva: Unë nuk e njoh atë terren se nuk kam qenë asnjëherë atje, kështu që me qenë me ortofotot unë e shoh interesin e komunës dhe të palës, d.m.th. e analizoj më në detaje.

znj. Kadrije Lika Troni: Sa po shihet këtu së pari është shtruar rruga pa e bërë shpronësim e pronës private, ndërkaq tani po doni me i përmirësuar gabimet e juaja të mëhershme.

Kryesuesi i Kuvendit, Kur është shtruar rruga, është bërë drejt, tani pronari e ka parë se ka hyrë komuna në pronën e tij dhe kërkon që ose t'i kompensohet në këtë mënyrë ose me shkuar përmes procedurave gjyqësore. Për atë, ne tani nuk po shtrojmë më rrugë pa nënshkrime të qytetarëve.

znj. Kadrije Lika Troni : A jeni në dijeni që gjatë fushatës është shtruar një rrugë të Vishajt pa pëlqimin e qytetarëve. A mundem unë të marrë veprime për një rrugë në Kovaçec dhe cilat janë procedurat. Unë e kam pyetur edhe drejtorin për procedurat, se kur e pash që ajo rrugë është shtruar pa procedura, u ndjeva shumë keq.

z. Agim Mani: Rruga të Vishaj është bërë për 2 ditë, në kohë fushate.

Kryesuesi i Kuvendit: Po jemi në dijeni, i kanë nënshkrimet e të gjithë pronarëve. Nëse pronarë fjala vjen janë tre familjarë, prona është e përbashkët, atëherë duhet me marrë pëlqimin e të gjithë pronarëve, me deklaram me shkrim.

Kryetari i Komunës, Nëse i keni nënshkrimet e të gjithë pronarëve të asaj rruge, znj. Kadrije mundeni me iniciuar procedurën, përndryshe vetëm 1 pronarë me qenë kundër, nuk mundeni. Deklarimet e pronarëve duhet të vërtetohen në gjykatë. Ne kemi shumë prona të cilat nuk është bërë bartja e tyre që 30 apo 40 vjet, si çështja e legalizimit të shtëpive, shtëpitë janë ndërtuar para disa vjetëve, ndërkaq bartja është duke u bërë tani. Ju njëherë duhesh me ardhur në komunë, me bërë bartjen në pronë komunale dhe me filluar procedura. Ajo të Vishaj procedurat janë zhvilluar një vjet më herët, dhe ka qenë në buxhet ky projekt.

z. Ramadush Osmani: Rrugica ku po thoni ju në lagjen Vishaj, ka qenë e projektuar dhe e buxhetuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Kemi dalë jashtë temës, se kjo çështje nuk është në rend pune, mundesh në KK me ngritur si çështje jashtë rendit të ditës.

znj. Kadrije Lika Troni : Jo nuk është jashtë rendit të ditës kryesues.

znj. Ardita Rrahmani: Këtu po e shoh se janë dy prona, të Duraj prona në emër të komunës që është rrugë publike e pa kategorizuar dhe prona private që është livadh i klasës së 5. Në çfarë kriteresh bëhet ky kategorizim se nuk e kam të qartë së nuk jam e lëmit. Nëse i merret pronë pronari, a duhet me ia dhënë pronën të njëjtës kategori, qysh është procedura ?

Kryesuesi i Kuvendit: Prona që karakterizohet si rrugë publike e pa kategorizuar, nuk mundet me u karakterizuar si arë e klasës të 5, ajo karakterizohet si rrugë publike e pa kategorizuar dhe mundet me qenë ngjitur prona private me atë komunale dhe ajo privatja është arë e klasës së 5, ose 2 apo 3. Rruga nuk ka klasë të kategorizimit. Se di sa isha i qartë, ndoshta drejtori e din me mirë këtë çështje.

z. Ramadush Osmani: Kur parcela shkrihet, atëherë i ndërrohet kategoria. Kur t'i ndërrohet kategoria një prone, atëherë merr kategorizim tjetër.

z. Qamil Stagova: Kategorizimet janë shënime të vjetra, për secilën pronë shënohet në certifikatë të pronësisë kategorizimi.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin me ia adresuar KK dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e ,

Aprovoj

Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00433-0 ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00453-0 ZK Duraj; dhe i njëjti i Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

8. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00139-2 ZK Biçec, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00162-0, ZK Biçec;

Kryesuesi i Kuvendit: Është rast i ngjashëm me pikën paraprake, e hapi diskutimin e kësaj pikë:

z. Suhad Dullovi-Drejtor i DBPZHR: Unë jam më në ngjarje për këtë rast. Sqaroj së ku gjinden pronat që këmbehen, arsyet e këmbimit, ku ka qenë rruga, dhe ku del rruga pasi të bëhet këmbimi i pronave.

z. Agim Mani: Në krahasim me propozimin e parë, të kjo çështja është me ndryshe, sepse lënda e ka pëlqimin e të gjithë pronarëve të tokave. Kjo pronë ka qenë e një pronari, është bërë trashëgimia, është bërë bartja, është noterizuar dhe lënda është me në rregull me dokumentacion.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim propozim vendimin me i kaluar KK. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00139-2 ZK Biçec, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00162-0, ZK Biçec; dhe i njëjti i, Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

9. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, parcelat kadastrale me numrat: 01306-2 dhe 01306-8, ZK Kaçanik i Vjetër, për shfrytëzimin e hapësirave shkollore;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky është një Propozim Vendim për shpallje me interes të pronës private për këmbim me pronën komunale për zgjerimin e hapësirave shkollore në Kaçanik të Vjetër. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Unë nuk e kam materialin, kështu që nuk kam çka me diskutuar.

z. Agim Mani: Parashtroj pyetje se ku gjinden këto prona, ndërkaq shtoj së, njëherë është ndërtuar shkolla, pastaj këto prona po kërkohet të shpallen me interes të përgjithshëm publik, d.m.th. nuk janë marrë veprimet paraprake para se me u ndërtuar shkolla.

Kryetari i Komunës: Pronat janë në oborr të shkollës, janë prona të cilat iu kanë ndarë refugjatëve të Kroacisë, njëherë nuk i kemi vërejtur ato prona, duke kemi menduar së janë prona komunale, deri sa kanë filluar njerëzit me blerë e më i legjitimuar ato prona. Gjashtë(6) parcela kanë qenë të refugjatëve nga Kroacia, por vetëm për 2 prona është bërë bartja e pronësisë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ata i kanë legjitimuar ato prona, ndërkaq ne i shpallim me interes të përgjithshëm publik që ata mos me pasur mundësi me i shitur, pastaj formohet komisioni në nivel qendror për vlerësimin e pronës dhe caktimin e çmimit. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtoj në votim për aprovim Propozim Vendimin me ia kaluar KK dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVOJ

Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, parcelat kadastrale me numrat: 01306-2 dhe 01306-8, ZK Kaçanik i Vjetër, për shfrytëzimin e hapësirave shkollore; dhe i njëjti i Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

10. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Është raport të cilin e miraton kryetari i komunës, mirëpo në grantin e performancës janë indikatorët të cilët përcaktojnë së raporti i auditorit të brendshëm kërkohet të shqyrtohet në KK.

Kryetari i Komunës: Sipas auditorës së komunës, nuk është në kompetencë të KK me shqyrtuar raportin e auditorit kuvendi, mirëpo MAPL e cila na monitoron komunat, kërkon që raporti i auditorit me shqyrtuar nga KK, përndryshe raporti i auditorit hyn në kuadër të raportit të kryetarit, e jo si i veçantë.

Kryesuesi i Kuvendit: Raportet e zyrave të kryetarit hyjnë në kuadër të raportit të kryetarit, mirëpo pasi po kërkohet me u ndarë për shkak të grantit të performancës, raporti është bërë i ndarë.

znj. Ardita Rrahmani: Të raporti i auditorit shihet se kemi një përqindje të ulët të zbatimit të rekomandimeve me 31 %, e që në krahasim më vitin 2020 zbatimi i rekomandimeve ishte 35%, d.m.th ka një rënie për 4% të zbatimit të rekomandimeve në vitin 2021.

Tjetër, ka gabime teknike e drejtshkrimore në materiale të mbledhjeve. Jo që nuk janë të kuptueshme për ne, ndoshta do të ishte mirë që gabimet teknike me u përmirësuar.

Kryetari i Komunës: Theksoj se do të merren veprime të nevojshme për përmirësimin e gabimeve teknike.

Kryesuesi i Kuvendit: Materialet duhet të vijnë pa gabime teknike e në veçanti Propozim Vendimet. Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK në procedurë. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, **E diskutoj Raportin e vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin 2021, dhe i njëjti kalon në procedurë të KK për diskutim.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:05. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 28 shkurt 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

I	Data	17.03.22	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	346/01-2660	/		

Në mbështetje të nenit 12, 17 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen lokale, nenit 73 të Statutit të Komunës, Ligjit për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179, Ligji Nr. 06/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor si dhe Statutit të Ndërmarrjes Publike “Stacioni i Autobusave” sh.a 01 Nr. 07-16-16540/2013, Kryetari i komunës pas konsultimeve të bëra me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave,

PROPOZON

Që, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e radhës, më datë _____ të shqyrton dhe aprovon këtë:

RREGULLORE

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES 01Nr. 346-18740/2013 datë 29.07.2013 PËR ÇAKTIMIN E TARIFAVE PËR NISJET E TRANSPORTIT RRUGOR NGA STACIONI I AUTOBUSAVE

1. Me këtë propozim rregullore, ndryshohet në tërësi teksti aktual i Nenit 10 (Tarifat e nisjeve nga stacioni i autobusave) të RREGULLORES 01Nr. 346-18740/2013 datë 29.07.2013 PËR ÇAKTIMIN E TARIFAVE PËR NISJET E TRANSPORTIT RRUGOR NGA STACIONI I AUTOBUSAVE,

Teksti aktual:

Çdo nisje nga stacioni i autobusave operatorët e transportit publik të udhëtarëve me autobus do të paguajnë për peron;

- Për linjat ndërrbane =2 €

Çdo nisje nga stacioni i autobusave operatorët e transportit publik të udhëtarëve me autobus do të paguajnë për peron;

- Për linjat urbano-periferike =1.30 €

Çdo nisje nga stacioni i autobusave operatorët e transportit publik të udhëtarëve me kombi-taksi do të paguajnë për peron;

- Për linjat urbano-periferike =0.70 €

Ndryshohet dhe plotësohet me tekstin e ri:

“Tarifat e nisjeve nga stacioni i autobusave për linjat ndërrbane, urbano-periferike dhe linjave me kombi-taksi të operatoreve të transportit publik të udhëtarëve, aprovohen nga Bordi i drejtorëve të NKP”Stacioni i autobusave”, konform Statutit të ndërmarrjes, me miratim të Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes, organ i formuar nga kuvendi komunal”.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas aprovimit në kuvendin komunal.



Besim Ilazi

Kryetar i Komunës

Arsyetim

Pasiqë neni 13, pika 1, i kësaj rregulloreje, thotë:

”Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Transport Rrugor dhe Statutit të ndërmarrjes “Stacioni i autobusave” sh.a, mbizoterojnë dispozitatat e ligjit dhe statutit” *kurse*, Te pika 13.5 (Përgjegjësitë e Bordit të drejtorëve) i nenit 13 të Statutit të ndërmarrjes “Stacioni i autobusave” në pikën (f) thuhet:

Bordi i drejtorëve është përgjegjës:

f. “të aprovoj propozimet për tarifa dhe të shqyrtoj aplikacionet e bëra nga kryeshefi ekzekutiv për dorëzim paraprak te organi për miratim”;

Andaj për t’i shmangur konfliktit të vendimarrjes dhe për të mos iu nënshtruar në vazhdimësi kjo rregullore plotësim ndryshimeve të nenit 10 për caktimin e tarifave, është parë më e arsyeshme që një përgjegjësi e tillë t’i bartet Komisionit Komunal të Aksionarëve të kësaj ndërmarrje, si organ i formuar nga kuvendi komunal, që është përgjegjës për monitorimin e punës së Bordit të ndërmarrjes.



Ramadush Osmani
Drejtör i DSHPE-së

Me këtë propozim rregullore njoftohen:

1. Kryesuesi i Kuvendit,
2. Anëtarët e KPF-së,
3. Arkivi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik
-KUVENDI I KOMUNËS-

01Nr.346-18740/13
Kaçanik, 29.07.2013

**RREGULLORE PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR NISJET E
TRANSPORTIT RRUGOR NGA STACIONI I AUTOBUSËVE**

Korrik 2013

Në mbështetje të nenit 12.2 (b), 14, 17 lidhur me nenin 40.2 (a) dhe (g) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/ L-40, të Ligjit për Transportit Rrugor Nr. 04 /L-179, si dhe Statutit të Ndërmarrjes Publike "Stacioni i Autobusëve" sh.a, 01 Nr. 07 -16-16540/2013, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur të mbajtur me datë 29.07.2013, nxjerrë këtë:

RREGULLORE PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR NISJET E TRANSPORTIT RRUGOR NGA STACIONI I AUTOBUSËVE

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Hartimi dhe miratimi i kësaj rregullore ka një rëndësi të veçantë për faktin se; Ndërmarrja Komunale "Stacioni i Autobusëve" sh.a, për momentin nuk ka burim tjetër financiar. Burim kryesor për funksionimin e kësaj ndërmarrje janë të hyrat që realizohen nga nisjet e linjave: urbane, urbanë-periferike dhe ndër urbane, me autobus dhe kombi-taksi, nga stacioni i autobusëve për transportin publik të udhëtarëve, sipas rrethit të udhëtimit.

Neni 2 Fushë veprimtarie

2.1 Kjo rregullore rregullon kushtet e qasjes së operatoreve të transportit rrugor të udhëtarëve që përdorin të paktën një automjet ose një tërësi mjetesh, për pagesën e peronimit gjatë nisjeve nga stacioni i autobusit.

2.2 Të gjitha nisjet dhe arritjet prej/në Kaçanik, të linjave: urbane, urbane-periferike dhe ndër urbane, kryhen përmes Ndërmarrjes Publike "Stacioni i Autobusëve" sh.a, prandaj edhe fushëveprimi i nisjeve për transportin publik të udhëtarëve, është i ndërlidhur kryesisht me Ndërmarrjen Publike "Stacioni i Autobusëve" sh. a.

2.3 Nuk lejohet asnjë nisje të autobusëve dhe kombi-taksi, jashtë parkingut të stacionit të autobusëve, të çfarëdo vije, vetëm nëse është e rregulluar ndryshe me akt nënligjor.

Neni 3

Përkufizime dhe referenca

- 1.1. **Ministria** - Ministria përkatëse për transport;
- 1.2. **Komunë** - njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përcaktuar sipas Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale;
- 1.3. **Rrugë publike** - një sipërfaqe me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, në të cilën mund të lëvizë çdo kush me kushte të caktuara me ligj dhe të cilën organi kompetent e ka shpall rrugë publike;
- 1.4. **Operator-taksi** - veprimtari e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe juridik;
- 1.5. **Stacion i autobusëve** - objekti me infrastrukturën përcjellëse të licencuar nga Ministria me qëllim të ofrimit të shërbime për operatorët e transportit rrugor të udhëtareve dhe udhëtarët;
- 1.6. **Vend-ndalje** - sipërfaqe e ndërtuar dhe të shënuar posaçërisht, e caktuar për ndaljen e autobusëve e që mundëson hyrjen, përkatësisht daljen e sigurt të udhëtarëve dhe bagazheve;
- 1.7. **Itinerar** - akti i cili përcakton kahun e lëvizjes së automjeteve në linjë;
- 1.8. **Lëshues i licencës** - organi i cili sipas dispozitave të këtij ligji është kompetent për lëshimin e licencës;
- 1.9. **Operator i transportit rrugor të mallrave** - veprimtarinë e çdo operatori transportues të mallrave që kryen transport për nevoja personale dhe palë të tretë, me anë të mjeteve motorike ose të mjeteve të kombinuara;
- 1.10. **Operator i transportit rrugor të udhëtareve** - veprimtari e çdo operatori që vepron me anë të mjeteve motorike që janë të përshtatshme për bartjen e më shumë se nëntë personave, përfshirë edhe vozitësin, dhe të destinuara për këtë qëllim, shërbimet e transportit të pasagjerëve për publik ose për kategori të veçanta të përdoruesit në këmbim të pagesës nga personi i transportuar ose nga organizatori transportit;
- 1.11. **Transport publik** - transport të cilin në kushte të njëjta mund ta shfrytëzojnë të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit;
- 1.12. **Transport publik linjor i udhëtarëve** - transporti i cili kryhet në relacionet e caktuara dhe sipas rendit të udhëtimit, çmimeve dhe kushteve të përgjithshme të transportit të përcaktuara paraprakisht;
- 1.13. **Licencë** - akti me të cilin operatori i transportit rrugor lejohet të ushtrohet veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve ose mallrave, stacionet e autobusëve dhe terminaleve të mallrave;

1.14. **Leje e transportit** - akti i caktuar me këtë ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare në bazë të cilës kryhet transporti rrugor i udhëtarëve ose i mallrave;

1.15. **Linjë** - relacioni ose tërësia e relacioneve të kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor, prej stacionit fillestar deri në stacionin, përkatësisht deri në vend-ndaljen përfundimtare, në të cilën transportohen udhëtarët sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të publikuar me një ose me më shumë nisje;

1.16. **Linjë ndër-urbane** - linjë e cila zhvillohet në rrugët publike magjistrale dhe regionale të Kosovës dhe që lidhë dy apo më shumë Komuna;

1.17. **Linjë ndërkombëtare** - linjë e cila stacionin fillestar e ka në territorin e Kosovës ndërsa atë përfundimtar jashtë territorit të Kosovës;

1.18. **Linjë urbane** - linja e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda kufijve urban të një Komune - qyteti;

1.19. **Linjë urbane-periferike** - linjë e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda territorit të një Komune;

1.20. **Linjë udhëtarësh** - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar, përkatësisht vend ndaljes së autobusëve me ndalje të detyrueshme në të gjitha stacionet, përkatësisht vend ndaljet e autobusëve përgjatë rrugës së përcaktuar në rend të udhëtimit;

1.21. **Linjë direkt** - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar të autobusëve, përkatësisht të vend ndaljes së autobusëve, e përcaktuar në rend të udhëtimit pa u ndalur nëpër vend ndalje përgjatë rrugës;

1.22. **Linjë ekspres** - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar të autobusëve, përkatësisht vend ndaljes së autobusëve të përcaktuara në rend të udhëtimit duke u ndalur edhe në ndonjë stacion të rëndësishëm të autobusëve, përkatësisht në vend ndalje të autobusëve të përcaktuara në rend të udhëtimit;

1.23. **Transport linjor ndër-urban** - transport publik i udhëtarëve ndërmjet dy ose më tepër komunave, kurse mund të kryhet si transport linjor i udhëtarëve, ekspres ose direkt;

1.24. **Udhëtar** - personi / personat fizik të cilët transporton nga operatorët e transportit rrugor me kompensim dhe i cili në bazë të kontratës ka të drejtë transporti;

1.25. **Transport i veçantë linjor** - transportin e vetëm një numri të caktuar të udhëtarëve i cili kryhet në bazë të kontratës me shkrim ndërmjet operatorit të transportit dhe porositisit të transportit, me ç'rast transportin e paguan porositësi;

1.26. **Transport në komunikacionin rrugor** - çdo transport të udhëtarëve ose të mallrave, duke përfshirë edhe ngasjen e automjetit të zbrazët ose të pangarkuar;

1.27. **Transport për nevoja vetanake** - transport i personave ose të mallrave të cilin e kryejnë pa kompensim personat fizikë ose juridikë, për t'i plotësuar nevojat e

prodhimit ose të shërbimeve në kuadër të veprimtarive të veta;

1.28. **Operator i Transportit** - personi fizik ose juridik, vendor ose të jashtëm i cili posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së transportit në komunikacionin rrugor;

1.29. **Relacion** - distancë ndërmjet dy vendeve të linjës të cilat në rend të udhëtimit janë shënuar si stacione të autobusëve, përkatësisht si vend ndalje të autobusëve;

1.30. **Operator transportues i vendit** - person fizik ose juridik me seli/vendqëndrim në Kosovë i cili posedon licencën për kryerjen e transportit ose kryen transport për nevoja vetanake në përputhje me këtë ligj;

1.31. **Terminali i mallrave** - objekt me sipërfaqe përcjellëse që të ofrojë shërbime për pranimin dhe përcjelljen e automjeteve transportuese të operatorëve transportues;

1.32. **Transport transit** - transport i udhëtarëve ose të mallrave nëpër territorin e Republikës së Kosovës pa hyrjen ose daljen e udhëtarëve, përkatësisht pa ngarkuar ose shkarkuar mallrat në Kosovë;

1.33. **Rendi i udhëtimit** - akt i cili përmban: emërtimin e operatorit të transportit, linjën në të cilën kryhet transporti, llojin e linjës, radhitjen e stacioneve të autobusëve, përkatësisht të vend ndaljeve të autobusëve, pastaj distancën nga vendi ku fillon linja, kohën e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve, përkatësisht në vend ndaljet e autobusëve, regjimin e mbajtjes së linjës, periudhën brenda të cilës mbahet linja dhe afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit;

1.34. **Tarifë** - akt i cili përmban çmimin lidhur me kryerjen e shërbimeve dhe kushteve tjera transportuese;

KREU II

PËRGJEGJËSIT E KOMUNËS NË RREGULLIMIN E TRANSPORTIT RRUGOR

Neni 4

Përgjegjësit e komunës

1. Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj si vijon:

- 1.1. transportin e rregullt të udhëtarëve;
- 1.2. transportin e lirë të udhëtarëve;
- 1.3. transportin taksi të udhëtarëve;
- 1.4. transportin e udhëtarëve për nevoja vetanake.

Neni 5

Linjat e rregullta me autobus

1. Linjat ndër-urbane:

- 1.1 Kaçanik- Prishtinë,
- 1.2 Kaçanik – Ferizaj,
- 1.3 Kaçanik – Hani i Elezit.

2. Linjat urbane – periferike:

- 2.1 Kaçanik – Biçec,
- 2.2 Kaçanik – Nikë,
- 2.3 Kaçanik – Doganaj-Sepetin.
- 2.4 Kaçanik – Dubravë,
- 2.5 Kaçanik – Elezaj,
- 2.6 Kaçanik – Duraj,
- 2.7 Kaçanik – Gërlicë,
- 2.8 Kaçanik - Semajë,
- 2.9 Kaçanik – Stagovë,
- 2.10 Kaçanik – Kaçanik i Vjetër,
- 2.11 Kaçanik – Bergracë,
- 2.12 Kaçanik – Ivajë,
- 2.14 Kaçanik – Gllloboçicë,
- 2.15 Kaçanik - Imisht.

Neni 6

Linjat e rregullta me kombi-taksi

1. Linjat urbane – periferike:

- 1.1 Kaçanik – Kovaçec,
- 1.2 Kaçanik – Gajre,
- 1.3 Kaçanik – Ivajë,
- 1.4 Kaçanik – Kotlinë,
- 1.5 Kaçanik – Bajnicë,
- 1.6 Kaçanik – Strazhë.

KREU III

DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSIT E STACIONIT TË AUTOBUSËVE

Neni 7

Rendi i Udhëtimit

1. Rendi i Udhëtimit sipas Ligjit për Transportin Rrugor, është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor i cili përmban:

- 1.1. emrin e operatorit;
- 1.2. relacionin;
- 1.3. llojin e transportit;
- 1.4. radhitjen e vend-ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare në Km;
- 1.5. kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend-ndalje;
- 1.6. ditët e operimit, periudha kohore në të cilën mbahet linja;
- 1.7. afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.

2. Te gjitha nisjet për transportin publik të udhëtarëve të operatoreve me autobus dhe kombi-bus, për linjat: urbane, urbane periferike, dhe ndër urbane, realizohen përmes Stacionit të Autobusëve, sipas Rendit të Udhëtimit, regjistruar dhe vërtetuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.

Neni 8

Stacionet e autobusëve

Stacioni i autobusëve është objekti me infrastrukturën e saj përcjellëse për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit të udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjen dhe rezervimin e biletave për udhëtar, gardërobën, pajisjen për informimin e udhëtarëve dhe operatorëve të transportit, si dhe shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorët e transportit rrugor.

Neni 9

Detyrimet e stacioneve të autobusëve

1. Stacioni i autobusëve nuk ofron shërbime për operatorët e transportit të cilët nuk kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar nga organi përkatës për transportin rrugor të udhëtarëve.
2. Stacioni i autobusëve duhet të ketë mbishkrimin “Stacioni i autobusëve” si dhe emërtimin e vendit ku gjendet stacioni.
3. Stacioni i autobusëve është i detyruar që të mbajë librin e evidencës mbi hyrjen dhe daljen e autobusëve dhe për të njëjtën gjë të raportoj në Ministri në periudha tre (3) mujore.
 - 3.1. libri i evidencës mbi hyrjen dhe daljen e autobusëve duhet të ketë këto të dhëna:
 - 3.1.1. emrin e operatorit të transportit;
 - 3.1.2. emrin e linjës sipas rendit të udhëtimit;
 - 3.1.3. koha e shkuarjes dhe e ardhjes së autobusit;
 - 3.1.4. targat e regjistrimit të automjetit;
 - 3.1.5. fleturdhëresën e rrugës (Nr. Serik).
4. Me hyrjen në fuqi të rendit të udhëtimit, stacioni i autobusëve është i detyruar të bëjë sistematizimin e të gjitha rendeve të udhëtimit sipas relacioneve, kohën e nisjes së autobusit nga stacioni i tij.
5. Licencën për kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve të stacionit të autobusëve e lëshon Ministri, nëse stacioni i autobusëve është i destinuar për kryerjen e shërbimeve në transportin ndër-urban dhe të jashtëm. Ndërsa për stacionet që janë të destinuara për kryerjen e shërbimeve të transportit urban licencën e lëshon Komuna.

Neni 10

Tarifat e nisjeve nga Stacioni i Autobusëve.

1. Për linjat ndër urbane.

1.1 Për çdo nisje nga stacioni i autobusëve, gjatë transportit publik të udhëtarëve në linjat ndër urbane, sipas rendeve të udhëtimit, operatorët me autobus do të paguajnë për peron **2 €**.

2. Për linjat urbane –periferike.

2.2 Për çdo nisje nga; stacioni i autobusëve, gjatë transportit publik të udhëtarëve në linjat urbane- periferike, sipas rendeve të udhëtimit, operatorët me autobus do të paguajnë për peron **1,30 €**.

2.3 Për çdo nisje nga; stacioni i autobusëve, gjatë transportit publik të udhëtarëve në linjat urbane-periferike, sipas rendeve të udhëtimit, operatorët me kombi-taksi, do të paguajnë për peron **0,70 €**.

KREU IV DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 11 Mbikëqyrja inspektuese

Punët e inspektimit në transportin rrugor urban, urban-periferik, mallrave dhe transportin auto taksi brenda territorit të komunës i bënë inspektori rrugor komunal dhe Policia e Kosovës, përkatësisht policia e trafikut në kuadër të kompetencave të veta të përcaktuara me ligj.

Neni 12 Masat ndaluese dhe ndëshkimore

1. Përveç masave ndëshkuese të parapara me Ligjin e Transportit Rrugor, kjo rregullore parasheh edhe disa masa tjera shtesë:

1.1 Automjeti për transportin publik të udhëtarëve nuk guxon më shumë se 30 minuta me qëndruar i parkuar në peron para se të niset, nëse peroni është i caktuar për më shumë se një operator.

1.2 Prej orës **8:00** deri me ora **20:00** nuk lejohet hyrja e asnjë automjeti, për pos atyre automjeteve që bëjnë transportin publik të udhëtarëve, sipas rendeve të udhëtimit. Furnizim me ushqime për lokalet afariste brenda stacionit të autobusëve, mund të bëhet në kohën jashtë këtij orari.

1.3 Gjatë inspektimeve të bëra nga inspektorët komunal, nëse personi përgjegjës i automjetit për transportin publik të udhëtarëve gjendet pa biletë peroni, atëherë organi kompetent do të marr masa për dënim mandator prej **50 deri 100 €**.

1.4 Për ndalesat sipas paragrafit 1.1 dhe 1.2 të nenit 12, do të përkujdeset stafi menaxhues i Ndërmarrjes Publike “Stacionit të Autobusëve” sh.a.

Neni 13

Dispozitat përfundimtare

1. Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Transportin Rrugor dhe Statutin e Ndërmarrjes Publike "Stacioni i Autobuseve" sh.a, mbizotrojnë dispozitat e ligjit dhe statutit.
2. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njejtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.
3. Për zbatimin e kësaj rregullore do të përkujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, inspektorët e komunës, Bordi i Drejtorëve të N.P "Stacioni i Autobuseve" sh.a, dhe menaxhmenti i kësaj ndërmarrje.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Rregullorja pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL-së, si dhe Publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i kuvendit,
Xhelal Gashi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

I	Data	17.03.22	Vendi	KASANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/02-7676	/		

Në mbështetje të nenit 12, 17 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen lokale, nenit 73 të Statutit të Komunës, pas konsultimeve të bëra me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Kryetari i komunës bënë këtë,

PROPOZIM

Që, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e radhës, më datë _____ të shqyrton dhe aprovon këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË MENAXHIM TË PËRKOHSHËM TË PARKINGJEVE NË PRONËSI TË KOMUNËS NDËRMARRJES PUBLIKE KRM "PASTËRTIA" SH.A-NJËSIA NË KAÇANIK

- I. Me këtë Vendim iu jepet në menaxhim të përkohshëm KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik, parkingjet publike në pronësi të komunës,
- II. KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik do t'i mirëmbajë dhe inkasoj mjetet që gjenerohen nga vendparkingjet e komunës,
- III. Mjetet e inkasuara do të shfrytëzohen nga KRM "Pastërtia"-njësia në Kaçanik, e njejta do t'i përdorë për nevojat e funksionimit të kompanisë,
- IV. Tarifat e shfrytëzimit të vendparkingjeve caktohen në bazë të Rregullores për Taksa komunale,
- V. KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik në kundërvlerë të këtij aktiviteti do t'i mirëmbajë hapësirat publike (bulevardin "Ismajl Raka", shetitoret përgjatë lumit Nerodime, Parkun e Qytetit dhe hapësira tjera sipas marrëveshjes me komunën),
- VI. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë mes komunës dhe KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik do të precizohen përmes një marrëveshje "në shtëpi" (in house) e rregulluar konform ligjeve në fuqi,
- VII. Ky Vendim hyn në fuqi pas aprovimit në kuvendin komuna,
- VIII. Për respektimin e këtij Vendimi do të përkujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

Besim Ilazi

Kryetar i Komunës



Arsyetim

Duke ju referuar Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, përkatësisht Nenit 9, pika 4 ku shprehimisht thuhet që *“Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të merr masa të arsyeshme për t’u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”*.

KRM “Pastërtia” sh.a-njësia në Kaçanik, si ndërmarrje publike me vetëfinancim, e krijuar në bazë të Ligjit për Ndërmarrje Publike, ku aksionare e saj është edhe komuna e Kaçanikut, këto aktivitete të planifikuara nga komuna ndërlidhen me veprimtarinë e kësaj ndërmarrjeje si dhe me procesin e decentralizimit financiar të njësisë së KRM “Pastërtia” në Kaçanik nga sistemi regjional me qendër në Ferizaj, mundësohet një e hyrë shtesë krahas të hyrave nga veprimtaria e grumbullimit të mbeturinave komunale.

Komuna e Kaçanikut, si aksionere e ndërmarrjes, do të përpiqet që të mundësoj aktivitete shtesë kompanisë publike që kompania të mos ballafaqohet në vazhdimësi me vështirësi financiare dhe me pamundësi të mbulimit të kostos së shpenzimeve veta .

Ramadush Osmani

Drejtör i DSHPE-së

Me këtë propozim të vendimit njoftohen:

1. Kryesuesi i Kuvendit,
2. Anëtarët e KPF-së dhe
3. Arkivi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 - Nr. 400/01-2825/22
Kaçanik, 18.03.2022

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit Nr.07/L-041 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës Kaçanik,

Propozon Kuvendit Komunal këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE TË PA SHPENZUARA NGA VITET PARAPRAKE NË BUXHETIN E KOMUNËS TË VITIT 2022

1. Me këtë Vendim, bëhet bartja e mjeteve të vetanake të paspenzuara nga viti fiskal 2020 dhe 2021 në buxhetin e komunës të vitit 2022.
2. Buxheti i Komunës së Kaçanikut i miratuar për vitin 2022 në shumë prej 9,193,167.00 euro, pas bartjes së mjeteve të pa shpenzuara nga vitet paraprake në shumë prej **706,271.35** euro, do të arrijnë shumën e përgjithshme, **9,899,438.35** euro.
3. Mjetet e pa shpenzuara në shumë prej **706,271.35** euro, barten si vijon:
 - 3.1. Subvencione dhe Transfere shuma prej 10,000.00 euro dhe
 - 3.2. Investime Kapitale shuma prej..... 696,271.35 euro.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë; Shtojcat A dhe B të pasqyrave tabelare e bilanceve të pa shpenzuara nga vitet fiskale 2020 dhe 2021 dhe rindarja e mjeteve të bartura në buxhetin e vitit 2022 në Nënprogramet përkatëse, kategoritë ekonomike dhe kodet e projekteve.
5. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- 1.KPF
- 2.Kuvendi i Komunës, dhe
- 3.Arkivi.



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

SHTOJCA - B : Rishpërndarja e mjeteve të bartura në 2022

PASQYRA TABELARE
PËR RISHPËRNDARJEN E MJETEVE TË PASHPENZUARA TË VITIT 2020 DHE 2021, NË VITIN 2022
(SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE)

Tabela 4.

Nr.	Programet Buxhetore	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhv. Rural, nënprogrami 47028	-			10,000.00	-	10,000.00
2	Buxhet dhe Financa, nënprogrami 17528	-				50,000.00	50,000.00
3	Shërbime Publike dhe Emergj, nënprogrami 18028					436,271.35	436,271.35
4	Planifikimi Urban dhe Mjedisi, nënprogrami 66445					80,000.00	80,000.00
5	Kultura, rinia dhe spotet, nënprogrami 85028	-				10,000.00	10,000.00
6	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 92140	-				40,000.00	40,000.00
7	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 93810	-				50,000.00	50,000.00
8	Zhvillimi Ekonomik, nënprogrami 48028	-				30,000.00	30,000.00
	TOTALI :	-	-	-	10,000.00	696,271.35	706,271.35

► **SHPËRNDARJA E MJETEVE PËR INVESTIMEVE KAPITALE (22/300) SIPAS KODEVE EKONOMIKE DHE KODEVE TË PROJEKTEVE NË SHUMË**
TOTALE PREJ 696,271.35€, DO TË BËHET SIPAS KËSAJ PASQYRE TABELARE:

Tabela 5.

Nr.	INVESTIMET KAPITALE	Kodi Programit	Kodi i Projektit	Shuma :
1	Mjetet për bashkëfinancim të projekteve	17528	86245	50,000.00
2	Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellëseve	18028	45490	50,000.00
3	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Idriz Seferi	18028	51631	100,000.00
4	Ndërtimi i objektit për Zjarrefiksesit - Kaçanik	18028	50170	150,000.00
5	Rehabilitimi i rrugës Qamil Ilazi dhe Sali Bajra	18028	i rii	20,000.00
6	Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Beqracë	18028	i rii	100,000.00
7	Vendosja e tabelave digjitale me mbishkrimin mire se vini ne Kaçanik	18028	51637	6,271.35
8	Ndërtimi dhe rregullimi i parqeve publike	18028	48264	10,000.00
9	Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave	66445	50199	30,000.00
10	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale-Kaçanik	66445	50201	50,000.00
11	Ndërtimi i Memorialit për viktimat civile të luftës	85028	51025	10,000.00
12	Renovimi i Objekteve dhe Infrastrukturës shkollore	92140	86263	40,000.00
13	Ndërtimi i sallave të Edukatës Fizike ne SHFMU: "Nazmi Osmani" Elezaj, "Jusuf Gërvalla" Biqec, "Idriz Seferi" Bob dhe "Kadri Zeka" Dubravë, faza I-rë	93810	50210	50,000.00
14	Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriqimit publik ne rrugen Murat Lika Shtrazë	48028	51648	30,000.00
	Totali (1deri 16) :			696,271.35

Drejtori për Buxhet dhe Financa
 Bahri Selimi



PASQYRA TABELARE
E MJETEVE TË PASHPENZUARA TË VITIT 2020 DHE 2021
SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE

1/. HVK-të e pa shpenzuara të vitit 2020

Tabela 1.

Nr.	Programet Buxhetore	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Sherbimet sociale dhe rezidenciale, nënprogrami 75636					6,645.98	6,645.98
2	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhv. Rural, nënprogrami 47028				323.20		323.20
3	Planifikimi Urban dhe Mjedisi, nënprogrami 66445					55,524.53	55,524.53
4	Shërbime Publike dhe Emergj, nënprogrami 18028	-				29,229.96	29,229.96
5	Buxhet dhe Financa, nënprogrami 17528	-				46,354.99	46,354.99
6	Kultura, rinia dhe spotet, nënprogrami 85028	-			0.40		0.40
7	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 95010		0.23				0.23
8	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 93810		3,000.00				3,000.00
	TOTALI :	-	3,000.23	-	323.60	137,755.46	141,079.29

2/. HVK-të e pa shpenzuara të vitit 2021

Tabela 2.

Nr.	Programet Buxhetore	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Zhvillimi Ekonomik, nënprogrami 48028	-			1,200.00	50,235.37	51,435.37
2	Shërbime Publike dhe Emergj, nënprogrami 18028	-	343.37			64,207.44	64,550.81
3	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhv. Rural, nënprogrami 47028	-	1,642.71				1,642.71
4	Planifikimi Urban dhe Mjedisi, nënprogrami 66445	-				39,908.58	39,908.58
5	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale, nënprogrami 74700	-				15,000.00	15,000.00
6	Administrata dhe Personeli, nënprogrami 16328	-				11,090.00	11,090.00
7	Kultura, rinia dhe spotet, nënprogrami 85028	-			1,800.00	9,936.82	11,736.82
8	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 92750	-	460.12				460.12
9	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 92140	-			47.00	26,045.85	26,092.85
	TOTALI :	-	2,446.20	-	3,047.00	216,424.06	221,917.26

C/. PËRMBLEDHJA (A+B) :

Tabela 3.

Nr.	Programet Buxhetore	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Administrata dhe Personeli, nënprogrami 16328		-		-	11,090.00	11,090.00
2	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhv. Rural, nënprogrami 47028		1,642.71		323.20	-	1,965.91
3	Buxhet dhe Financa, nënprogrami 17528	-			-	46,354.99	46,354.99
4	Shërbime Publike dhe Emergj, nënprogrami 18028	-	343.37		-	93,437.40	93,780.77
5	Zhvillimi Ekonomik, nënprogrami 48028	-			1,200.00	50,235.37	51,435.37
6	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 95010		0.23		-	-	0.23
7	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 93810		3,000.00		-	-	3,000.00
8	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 92750		460.12		-	-	460.12
9	Arsimi dhe Shkenca, nënprogrami 92140		-		47.00	26,045.85	26,092.85
10	Planifikimi Urban dhe Mjedisi, nënprogrami 66445	-	-		-	95,433.11	95,433.11
11	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale, nënprogrami 74700	-	-		-	15,000.00	15,000.00
12	Sherbimet sociale dhe rezidenciale, nënprogrami 75636	-	-		-	6,645.98	6,645.98
13	Kultura, rinia dhe spotet, nënprogrami 85028	-	-		1,800.40	9,936.82	11,737.22
14	Pjesa e hvk te pa-alokuara					343,274.80	343,274.80
	TOTALI :	-	5,446.43	-	3,370.60	697,454.32	706,271.35



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Kaçanik Kaçanikut

Komuna e Opština

Municipal Kaçanik

Data	16.03.22	Vendi	KAÇANIK
Nr. org.	Nr. ri	Shtojcë	
01	470/03-7566	/	

Për	Zyrën Kombëtare të Auditimit
Kopje	Kryesuesi i Kuvendit Komunal Kaçanik
Nga	Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi
Datë	14.03.2022

RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Në bazë të nenit 14, pika 5 e Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, në fuqi që nga qershori 2019, ku thuhet se: *Pas hartimit të planit të veprimit, entiteti i audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit/aksionarit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Raportet dorëzohen dy here në vit, respektivisht deri më 30 shtator dhe 15 mars.*

Prandaj, në përgjigje të kësaj kërkesë, Komuna e Kaçaniku ka përgatitur këtë raport lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit.

Shtator 202

RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE, KOMUNA E KAÇANIKUT

Raportimi për afatin 15 Mars 2022

Nr	Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Statusi i rekomandimit(i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1	Shpalosje jo e plotë e të hyrave dhe detyrimeve kontingjente në PFV	Sipas nenit 21 të Rreg.nr.01/2017 për Raportim vjetor financiar nga OB - Organizatat buxhetore raportojnë shumën e të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak, pranimet gjatë vitit fiskal që kanë qenë në dispozicion për shpenzime gjatë periudhës së raportimit; si dhe bilancin e pa shpenzuar në fund të periudhës raportuese, si dhe neni 18, parasheh se "Organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente".	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që informatat e shpalosura në PFV në lidhje me të hyrat indirekte dhe detyrimet kontingjente janë të plota dhe konsistente nëpër vite.	Janë paraqitur këto shifra me rastin e hartimit të PVF/2021 në mënyrë të saktë.	zbatuar	Nuk ka pasur sfida në zbatimin e këtij rekomandimi.
		Në PFV 2020 tek neni 21 raporti për të hyrat vetanake të pashpenzuara, shuma e mbetur për bartje është nënvlerësuar për 130,512€, pasi që nuk ishin paraqit të hyrat indirekte (të hyrat nga dënimet e policisë, globave të gjykatave dhe të hyrave nga agjencioni i pyleve).				

		Të hyrat e bartura të prezantuara në PFV ishin 375,840€, ndërsa shuma për bartje do duhej të ishte 506,352€. Po ashtu, te neni 18 vlera e detyrimeve kontingjente të pazgjidhura të vitit 2019 nuk ishin bartur në kolonën e vitit 2020.					
2	Mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore	Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës. Po ashtu, sipas nenit 31, pika 6, Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar. Ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim: - Nga 9,034 prona të evidentuara në bazën e të dhënave (objekte), komuna në vitin 2020 kishte arritur të inspektoj 1,199 apo 13% e pronave të paluajtshme; dhe - Nga gjithsej 129 ankesa të shqyrtuara nga komuna (67 objekte dhe 62 parcela) në lidhje me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë në 122 raste	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, Kryetari duhet të shtojë kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësimi i saktë i tatimit në pronë për taksa paguesit, dhe	Vështrësitë kryesore për mospërmbushjen e planit rreth verifikimit të tërësishëm pronave ka qenë prezenca e Pandemisë C-19. Përkundër kësaj, ne kishim rritur kapacitetet teknike dhe njerëzore në këtë drejtori për të përshpejtuar këtë proces, mirëpo gjatë vitit 2021 është paraqitur nevoja për zëvendësim të stafit në sektorin e financave, pra zyrtari i tatimit në pronë ka zëvendësuar gjatë gjithë vitit zyrtaren tjetër me rastin e pushimit të lehonisë. Ndersa ky proces është zhvilluar vetëm në kuader të kordinimeve me drejtorinë e urbanizimit ku të gjitha pronat që iu nënshtrohen legalizimit, dokumentet për të njëjtat do t'i dorëzohen Tatimit në Pronë, në mënyrë që	Pjesërisht i zbatuar	Nuk ka pasur sfida në zbatimin e këtij rekomandimi.	

		ishin aprovuar në favor të tatimpaguesve. Shqyrtimi i këtyre ankesave në dy raste* ishte bërë me vonesë, duke tejkaluar afatin ligjor për shqyrtim deri në pesë muaj .	në raste të ankesave të mundshëm ato të shyrtohen brenda afateve ligjore.	t'u përditësohen shënimet në sistem. Ndërkaq, ankesat janë trajtuar të gjitha brenda afateve ligjore. <i>Në fillim të vitit 2022 ka perfunduar procesi i rekrutimit të stafit. Tani ZTP është me funksionale dhe gjatë këtij viti do të realizohet procesi i teresisëm i verifikimit të pronave.</i>		
3	Regjistrimi i të hyrave në kode jo adekuate ekonomike	Verifikimi jo i plotë i pronave dhe trajtimi me vonesë i ankesave kishin ndodhë edhe për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19, duke pasur parasysh se një kohë zyrtarët kanë qenë në izolim, pastaj është punuar me reduktime. Sipas nenit 44.1 të LMFPP përcakton që- Zyrtari Kryesor Financiar-ZKF i organizatës buxhetore, do të regjistrojë të gjitha transaksionet dhe do të mbajë regjistrat kontabël në përputhje me aktet nënligjore, gjithashtu sipas procedurave të MFK-së Nr.7, pika 6.1. Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) është përgjegjës për: pika 6.1.3 (ii) "Rakordimin e të hyrave në SIMFK me faturat dhe pasqyrat bankare". Ne identifikuar se si rezultat i regjistrimit jo adekuat të të hyrave nëpër kode ekonomike kemi diferenca të të hyrave sipas të hyrave reale dhe atyre të regjistruara në SIMFK:	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të financave se drejtoritë që mbledhin të hyra bashkëpunojnë ngushtë me zyrtarin e të hyrave në mënyrë që të eliminohen këto gabime dhe të hyrat të regjistrohen në SIMFK sipas kodit përkatës të të hyrave në pajtim me planin kontabël.	Nga zyrtari i regjistrimit të të hyrave janë regjistruar dhe koduar të hyrat në mënyrën e duhur.	zbatuar	Nuk ka pasur sfida në zbatimin e këtij rekomandimi.

83,196€, ndërsa sipas të dhënave nga drejtoria e urbanizimit janë 40,132€;						
- Të hyrat nga taksa për legalizimin e objekteve në SIMFK ishin 2,156€, ndërsa sipas të dhënave nga drejtoria e urbanizimit janë 14,156€; dhe - Të hyrat nga lejet mjedisore komunale në SIMFK ishin 988€, ndërsa sipas të dhënave nga drejtoria e urbanizimit janë realizuar 5,561€.						
Sipas nenit 61.23 të Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ.						
Ne identifikuam se për projektin "Zgjerimi i rrugës Avdullahim Shehu" e nënshkruar me 23.07.2020 në vlerë prej 199,935€, menaxheri i kontratës kishte aprovuar ndryshime të pozicioneve të kontratës pa një aprovim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ si në vijim:						
Sasitë sipas specifikacionit teknik të pozicioni 8" Furnizimi dhe vendosja e asfaltbetonit me trashësi prej 6 cm, përpunimin e trotuarit me gjerësi 1.40m" ishin 2016m² ndërsa sipas librit ndërtimor ishin realizuar 1836m² apo 180m² më						
					</	

		pak. Këto ndryshime ishin bërë me aprovim nga menaxheri i kontratës por jo edhe Zyrtari Kryesor Administrativ. Në situacionin përfundimtar ky pozicion ishte kalkuluar për pages si i plotë. Po ashtu, për këtë kontratë ishte nënshkruar edhe aneks kontrata, ku gjashtë pozicione kishin pësuar ndryshime të theksuara të sasive përkundër që vlera totale e aneks kontratës nuk kishte ndryshuar.	kërkesë për aprovim të ndryshimeve duke arsyetuar kërkesën për ndryshim dhe marrë aprovimet e duhura.			
5	Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosjen e informatave në PFV	Rregullorja MF-nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton qartë rregullat dhe procedurat për menaxhimin e pasurive dhe stoqeve dhe aktivitetëve në lidhje me inventarizimin e pasurive. Ne kemi identifikuar mangësi në menaxhimin e regjistrave dhe shpalosjen e tyre në PFV si në vijim: - Komuna kishte formuar komisionin për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive dhe hartuar raportin e përgjithshëm të inventarizimit, mirëpo nuk e kishte harmonizuar me regjistrin kontabël dhe PFV; - Pasuritë e blera nën 1,000€ gjatë vitit 2020 nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.	Menaxhimi i dobët i pasurive ka ndikuar në shpalosjen jo të saktë të pasurive e që për pasojë kemi një nënvlerësim të pasurive në PFV. Mangësitë e identifikuar, po ashtu ndikojnë që menaxhmenti të mos ketë informatat e sakta për gjendjen e pasurive që janë në dispozicion të komunës duke i vështirësuar marrjen e vendimeve të duhura për investime të reja për pasuri.	Gjatë vitit 2021 në mungesë të funksionimit të rregullt të sistemit E-Pasuria, regjistrimet janë mbajtur në menyrë manuale, mirepo me rastin e funksionimit të këtij sistemi në fund të vitit, kemi arritur ti regjistrojmë gjitha furnizimet me paisje me vlerë nën 1000 euro në sistem.	zbatuar	Nuk ka pasur sfida.

		Shpalosja e pasurive jo kapitale në PFV ishte bërë sipas vlerës së vitit paraprak duke mos e përfshirë zhvlerësimin dhe blerjet e vitit aktual. Sipas evidencave të thesarit shpenzimet (kodet e pasurive nën 1,000€) për vitin 2020 ishin në shumë 60,466€;						
		- Pasuria e cila ka të bëjë me investimet kapitale në dy shkolla në vlerë 40,252€ "Projekti auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje tjera të obligueshme" e theksuar edhe në raportin e auditimit 2019 ende nuk ishte regjistruar në regjistra, duke e nënvlerësuar pasurinë për këtë vlerë; dhe - Në raportin e auditimit 2019 ishte identifikuar se tre (3) kamion me vlerë prej 45,000€ të blerë me bashkëfinancim të komunës, Kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastërtia" dhe Shoqërisë Gjermane për bashkëpunim ndërkombëtarë sh.p.k (GIZ), nuk ishin regjistruar plotësisht. Pjesa e paguar nga bashkëfinancuesit prej 22,000€ ende nuk ishte regjistruar dhe për këtë vlerë kemi një nënvlerësim të pasurisë së komunës.						
6	Rritja e Llogarive të Arkëtueshme dhe shpalosje	Rregullorja nr. 01/2017 Për Raportim Vjetor Financiar, neni 16, obligon organizatat buxhetore që mbledhin të hyra	Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të sigurojë nga	Janë vendosur kontrole rigoroze tek të gjitha drejtoritë që krijojnë të hyra dhe LL	zbatuar	Nuk ka pasur.		

jo e saktë e tyre në PFV	që të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave". Të arkëtueshmet krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 105,056€. Kjo rritje ishte kryesisht te tatimi në pronë për shkak të situatës pandemike, por që një shumë të madhe të këtyre llogarive janë të ndikuara nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të menaxhuara/privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Problemet janë kryesisht me ndërmarrjet e privatizuara që kanë mbet borxh duke lu shtuar kamata dhe interesi. Vetëm borxhi i AKP për tatimin në prone është me vlerë prej 115,744€. Në PFV 2020 janë shpalosur LLA nga shfrytëzimi i pronës publike në shumë 25,391€ ku janë vërejtur diferenca në bartjen e saldove*. Po ashtu, komuna nuk na ka ofruar informacione mbi gjendjen e të arkëtueshmeve nga shfrytëzimi i pronës publike që ishin dërguar te përbaruesi në vlerë prej 45,966€.	
Në muajin janar 2022 janë ndërmarrë apo inicuar procedurat për borzlinjë fillimisht per borzlinjë me të mëdhenjë te tatimi në pronë. Kjo praktikë do të vazhdon gjatë vitit për gjitha kategoritë apo tatimpaguesit me obligim më të lartë se 300.00 euro, konform rregullores së Qeverisë së Kosovës.	drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen me një kujdes të veçantë nëpër vite. Çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore duhet të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit/arkëtimit të tyre bazuar në marrëveshjet e arritura me tatimpaguesit.	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



01- 104/02-7822/22

18.03.2022

R A P O R T

I PUNËS SË SHITABIT KOMUNAL PËR PARANDALIMIN E COVID-19
PËR KUVENDIN KOMUNAL NË KAÇANIK

KAÇANIK

2022

Hyrje:

Komuna e Kaçanikut që nga përhapja e rastëve të para me COVID-19 në Kosovë ka qenë e prekur nga ky virus. Ndonëse disa herë me numër me të madh të rastëve e disa herë të tjera me më pak raste por mbi të gjitha gjatë gjithë kësaj kohe situatë ka qenë mirë e menaxhuar dhe në kontroll.

Meqenëse nga muaji shtator e deri në fundvit të kaluar situatë ishte shumë më e qetë shtabi komunal nuk ka mbajtur takime.

Ndërsa më 27.01.2022 u mbajt takimi i parë i shtabit komunal për këtë vit.

Përshkak të ndryshimeve në ekzekutivin komunal ka ndryshuar edhe përbërja e disa anëtarëve të shtabit.

Përbërja e Shtabit Komunal për parandalimin e COVID-19:

Anëtarët e Shtabit Komunal janë emëruar nga institucione dhe subjekte të ndryshme të komunës tonë, kështu duke angazhuar të gjithë ata të cilët në mënyrë direkte do të kontribuonin parandalimit të këtij virusi dhe menaxhimit më të situatës së krijuar.

Shtabi Komunal përbëhet nga 16 anëtar si në vijim:

1. Besim Ilazi, Kryesues i Shtabit
2. Sabedin Vishi, Nënkyetar Komune
3. Sali Malsiu, Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
4. Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
5. Ramadush Osmani, Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
6. Fidaïm Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
7. Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
8. Agim Mani, Asambleist nga LVV
9. Kadri Krivanjeva, Asambleist nga PDK
10. Besnik Salihu, Asambleist nga LDK
11. Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
12. Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
13. Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
14. Ylber Tusha, përfaqësues i Bizneseve
15. Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordimin Emergjent
16. Besnik Bajra, Inspektor Sanitar

Mbledhjet e Shtabit Komunal:

Që nga formimi i shtabit e deri më tani janë mbajtur gjithësej 17 takime të shtabit komunal, 16 prej tyre janë të mbajtura me procesverbal, ndërsa takimi i parë nuk është mbajtur me procesverbal, për arsye teknike.

Në të gjitha takimet e mbajtura prezenca e anëtarëve të shtabit komunal ishte mjaftë e kënaqshme.

Ndërsa siç u thekësua në hyrje të këtij raporti gjatë këtij viti është mbajtur vetëm një mbledhje dhe rekomandimet nga ky takim janë si në vijim:

Rekomandimet e Shtabit Komunal:

Anëtarët e Shtabit Komunal si edhe në çdo takim tjetër ishin tejet bashkëpunues kështu duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm të angazhimit të tyre.

Secili prej tyre kishte ide dhe rekomandime të arsyeshme, me posht do ti paraqesim disa prej tyre, rekomandime të cilat ishin po ashtu të përcaktuara edhe nga Ministria e Shëndetësisë:

- Të respektohet distanca sociale;
- Të kenë kujdesë qytetarët gjatë ceremonive mortore në rastet e vdekjes nga COVID-19;
- Të bëhet dezinfektimi i objekteve dhe hapësirave publike;
- Të kërkohet dezinfektimi i Bizneseve dhe Barnatorëve nga ana e vet pronarëve;
- U kërkua nga qytetarëve të cilët vijnë për shërbime në të gjitha Institucionet Publike të vendosin maska dhe të jenë të vaksinuar;
- Të ketë kontrolla nga Inspektorati nëpër Biznese në fshatra dhe zona urbane;

Statistikat e personave të prekur me virusin COVID-19 në Komunën e Kaçanikut:

Që nga fillimi i pandemisë kemi pasur 1839 raste me COVID në Komunën tonë, të shëruar 1756 raste, të vdekur 40 raste ndërsa aktualisht janë 2 raste aktive nga të dhënat që i kemi deri më datën 24 Janar.

Janë kryer testimet në institucionet tona shkollore.

Të vaksinuar në Komunën tonë kemi gjithsej 33.916: në dozën e parë 17.929 qytetar. të dytë 14.522 qytetar dhe të tretë 1.455 qytetar.

Përfundim:

Për faktin se akoma ka rritje të numrit të vazhdueshëm të personave të infektuar me këtë virus dhe se duke mos e ditur se si do të shkojë më tejë rrjedha e kësaj pandemie, Shtabi Komunal vazhdonë të funksionoj edhe më tejë dhe do të jetë aktiv deri në një vendim tjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut-Kryesuesi i Shtabit Komunal

Z. Besim Hazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCE	07-217/01-7690/22
PËR/ZA/TO:	Zyrës së Kuvendit Komunal z. Kemajl Murseli - Kryesues i Kuvendit
Kopje:	z. Besim Ilazi, Kryetar i komunës
NGA/OD/FROM :	z. Ramadush Osmani, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:	DRAFT-RREGULLORE PËR MASAT DHE VEPRIMET PËR MBROJTJE NGA ZJARRI NË OBJEKTIN E KOMUNËS
DATË/E	

I nderuar

Bashkë me këtë shkresë zyrtare ju dërgoj kopjen e DRAFT-RREGULLORES PËR MASAT DHE VEPRIMET PËR MBROJTJE NGA ZJARRI NË OBJEKTIN E KOMUNËS, procedim të mëtutjeshëm si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës së kuvendit komunal.

Kjo rregullore përcakton sistemin e masave dhe veprimet e mbrojtjes dhe shpëtimit në Objektin e administratës komunale nga fatkeqësitë e zjarrit .
Draft-rregullorja është debatuar edhe me publikun dhe grupet e interesit me datën 01.03.2022.

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

I	Data	17.03.22	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	07		217	

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c) dhe 17, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, publikuar në (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), neni 9, të Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri, Nr-04/L-012, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7/10 2011) dhe nenit 73, pika 10 e Statutit të Komunës së Kaçanikut, pas konsultimeve me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Kryetari i komunës,

Propozon

Kuvendit i Komunës në Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me datën ----- të miratoi:

RREGULLOREN PËR MASAT DHE VEPRIMET PËR MBROJTJE NGA ZJARRI NË OBJEKTIN E KOMUNËS

I

Kjo rregullore përcakton sistemin e masave dhe veprimet e mbrojtjes dhe shpëtimit në objektin e Komunës nga fatkeqësitë e zjarrit.

II

2. Me këtë Rregullore përcaktohet:

- 2.1 Organizimi i mbrojtjes kundër zjarrit, detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të Komunës;
- 2.2 Mënyra e kryerjes së kontrollit të brendshëm dhe aplikimi i masave mbrojtëse nga zjarri;
- 2.3 Detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të cilët e kryejnë kontrollin e brendshëm;
- 2.4 Mënyra e njoftimit të punëtorëve me masat e rrezikshmërisë nga zjarri si dhe mënyra e reagimit në rast zjarri;
- 2.5 Mjetet dhe pajisjet teknike për shuarjen e zjarrit;
- 2.6 Përgjegjësia e punëtorëve në rast të mos përmbushjes së masave mbrojtëse nga zjarri;
- 2.7 Detyrat e punëtorëve në rast të lajmërimit të zjarrit, si dhe pjesëmarrja në shuarjen e zjarrit.

III

Rregullorja hynë në fuqi pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës



Besim Ilazi

Kryetar i Komunës

Arsyetim

Objektet e komunës janë objekte të rëndësishme publike dhe bëjnë pjesë në objektet e Kategorisë së Katërt (IV), siç përcaktohet me ligjin për Mbrojtje nga Zjarri.

Mbrojtja nga zjarri përfshin një tërësi masash dhe veprimesh të cilat caktohen dhe ndërmerren me qëllim të pengimit, të zgjerimit, lokalizimit dhe shuarjes së zjarrit si dhe shpëtimi i njerëzve dhe të mirave materiale, të cilat mund të rrezikohen nga zjarri në objektet e administratës së Komunës.

Mbrojtja nga zjarri organizohet dhe aplikohet në të gjitha objektet dhe hapësirat e administratës së komunës ku paraqitet rreziku nga shfaqja dhe përhapja e zjarrit.

Draft-Rregullorja është debatuar edhe me publikun dhe grupet e interesit.



Ramadush Osmani

Drejtör i DSHPE-së

Me këtë propozim të vendimit njoftohen:

1. Kryesuesi i Kuvendit,
2. Anëtarët e KPF-së dhe
3. Arkivi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

DRAFT-RREGULLORE PËR MASAT DHE VEPRIMET PËR MBROJTJE NGA ZJARRI NË OBJEKTIN E KOMUNËS

Mars 2022

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c) dhe 17, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, publikuar në (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), neni 9, të Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri, Nr-04/L-012, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7/10 2011) dhe nenit 73, pika 10 e Statutit të Komunës së Kaçanikut, pas konsultimeve me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Kryetari i komunës,

RREGULLORE PËR MASAT DHE VEPRIMET PËR MBROJTJE NGA ZJARRI NË OBJEKTIN E KOMUNËS

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo rregullore përcakton sistemin e masave dhe veprimet e mbrojtjes dhe shpëtimit në objektin e Komunës nga fatkeqësitë e zjarrit.

Neni 2

1. Me këtë Rregullore përcaktohet:

- 1.1 Organizimi i mbrojtjes kundër zjarrit, detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të Komunës;
- 1.2 Mënyra e kryerjes së kontrollit të brendshëm dhe aplikimi i masave mbrojtëse nga zjarri;
- 1.3 Detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të cilët kryejnë kontrollin e brendshëm;
- 1.4 Mënyra e njoftimit të punëtorëve me masat e rrezikshmërisë nga zjarri si dhe mënyra e reagimit në rast zjarri;
- 1.5 Mjetet dhe pajisjet teknike për shuarjen e zjarrit;
- 1.6 Përgjegjësia e punëtorëve në rast të mos përmbushjes së masave mbrojtëse nga zjarri;
- 1.7 Detyrat e punëtorëve në rast të lajmërimit të zjarrit, si dhe pjesëmarrja në shuarjen e zjarrit.

Neni 3

1. Objektet e komunës janë objekte të rëndësishme publike dhe bëjnë pjesë në objektet e Kategorisë së Katërt (IV), siç përcaktohet me ligjin për Mbrojtje nga Zjarri.
2. Mbrojtja nga zjarri përfshin një tërësi masash dhe veprimesh të cilat caktohen dhe ndërmerren me qëllim të pengimit, të zgjerimit, lokalizimit dhe shuarjes së zjarrit si dhe shpëtimi i njerëzve dhe të mirave materiale, të cilat mund të rrezikohen nga zjarri në objektet e administratës së Komunës.

Neni 4

1. Për organizimin e mbrojtjes nga zjarri janë përgjegjës:
 - 1.1 Kryetari i Komunës;
 - 1.2 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave;
 - 1.3 Drejtorët e Drejtorive;
 - 1.4 Stafi i Komunës;
 - 1.5 Personi përgjegjës për mbrojtje nga zjarri;

KREU II

MASAT MBROJTËSE KUNDËR ZJARRIT

Neni 5

1. Të gjithë punëtorët që janë në marrëdhënie pune dhe personat të cilët gjenden në objektin e administratës së Komunës, kanë për detyrë ti respektojnë masat mbrojtëse nga zjarri të përshkruara në këtë rregullore dhe akte tjera të dala nga ligji.
2. Mbrojtja nga zjarri realizohet me zbatimin e masave dhe normave organizative dhe teknike, preventive dhe profesionale.
3. Mbrojtja nga zjarri organizohet dhe zbatohet në të gjitha vendet dhe objektet e administratës së komunës të cilave ju kanoset rreziku nga zjarri.

Neni 6

1. Me qëllim të tejkalimit të shkaqeve të zjarrit, parandalimit të paraqitjes, përhapjes dhe shuarjes së zjarrit, shpëtimin të njerëzve dhe pasurisë të rrezikuar nga zjarri në objektet e Komunës ndërmerren këto masa:
 - 1.1 Gjatë projektimit dhe realizimit të punëve dhe adaptimeve në objektet ekzistuese, projektimit dhe ndërtimit të objekteve të reja, futjes së instalimeve dhe të pajisjeve në ato objekte, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së objekteve, aplikohen normat teknike dhe standardet për mbrojtje nga zjarri;
 - 1.2 Objektet e administratës së komunës duhet të jenë të pajisura me shkallët emergjente, të parapara për evakuim të menjëhershëm;
 - 1.3 Objektet duhet të jenë të pajisura me hidrantë, aparat alarmues dhe pajisje tjera të parapara, si dhe mjete për shuarje të zjarrit. Numri, lloji dhe lokacioni i këtyre mjeteve, caktohet me planin e mbrojtjes nga zjarri, si dhe me normat dhe standardet teknike të mbrojtjes nga zjarri;
 - 1.4 Instalimet dhe pajisjet elektrike të ventilimit, të ngrohjes, rrufepritësit, kanalizimit dhe të tjera në objekte mund të vendosen vetëm në mënyrën që të mos paraqesin rrezik nga zjarri. Punëtorët që kanë për detyrë mirëmbajtjen e instalimeve dhe pajisjeve të caktuara, kanë obligim që të bëjnë kontrollin e gjendjes dhe funksionimit të drejtë të pajisjeve dhe instalimeve, në atë mënyrë që në rast të dëmtimit të tyre, të mos shkaktojnë zjarrin në objektet e administratës së komunës;

- 1.5 Me planin për mbrojtje kundër zjarreve në objektet komunës caktohen lokalet ku ndalohet pirja e duhanit afër tyre. Vendosja dhe ruajtja e lëndëve djegëse si dhe materialeve tjera të cilat janë të prira për ndezje të lehtë, mund të bëhet vetëm në lokale të posaçme të deponimit në objekte, që janë ndërtuara sipas dispozitave për vendosjen dhe ruajtjen e këtyre materialeve. Për masat e ndalesave në vend të dukshëm theksohen vërejtjet përkatëse dhe shenjat e ndalimit.
- 1.6 Puna me zjarr të hapur, me aparate për saldim, prerje dhe ngjitje, mund të bëhet në lokale vetëm pasi paraprakisht të jenë marrë të gjitha masat e mbrojtjes nga zjarri dhe të jenë siguruar mjetet për shuarjen e tij.
- 1.7 Materialet e harxhuara, yndyrat, vajrat, ngjyrat, leckat, ambalazhet plastike, të drurit, si dhe materialet tjera të hedhura, jashtë përdorimit, pas përfundimit të ndërrimit, duhet të nxjerrën jashtë objekteve të administratës së Komunës, në rast të përdorimit të tyre.
- 1.8 Deponimi i materialeve në magazinë dhe lokale tjera, bëhet në harmoni me dispozitat dhe standardet në fuqi.
- 1.9 Në tavanet dhe kulmet e objekteve të komunës, ndalohet mbajtja e çfarëdo materiali apo pajisje, me përjashtim të pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit;
- 1.10 Lëndët djegëse dhe gazrat, nuk guxojnë të kalojnë përmes rrjetit të kanalizimit dhe të derdhen në kanalizimin kryesor;
- 1.11 Është i ndaluar riparimi i automjeteve brenda objekteve dhe hapësirave të objekteve të Komunës.
- 1.12 Në hapësirat e objekteve të komunës, nuk guxon të përdoren reshotë, nxehëset, radiatorët elektrikë, si dhe aparatet e ngjashme termoelektrike dhe gaz të ngrohjes pa marrjen e pëlqimit nga shërbimi emergjentë në komunë. Është e obliguar shkyçja e të gjitha këtyre aparateve termoelektrike, pajisjeve dhe mjeteve tjerë ngrohjes pas çdo përdorimi.
- 1.13 Hyrjet, daljet, kalimet dhe shkallët në objekte, duhet të jenë gjithmonë të lira për kalim.
- 1.14 Kryerja e punëve të rrezikshme që mund të nxisin zjarrin jashtë hapësirave të objekteve të administratës së Komunës, që janë parapara për qëllime të tilla, mund të lejohen vetëm më kusht që paraprakisht të jenë marrë të gjitha masat për mbrojtje kundër zjarrit.

Neni 7

1. Aparatet, pajisjet dhe mjetet e dedikuara për shuarjen e zjarrit, si dhe pajisjet dhe instalimet për lajmërimin dhe sinjalizimin automatik të zjarrit në objektet e komunës, mund të përdoren vetëm kur përmbushin kriteret dhe standardet e parapara teknike ose pas marrjes së pëlqimit, nga organizata e autorizuar e zjarrfikësve.
2. Aparatet, pajisjet dhe mjetet për shuarjen e zjarrit, vendosen në vende të dukshme dhe ku qasja është e lirë, në të gjitha objektin e administratës së komunës. Ato mund të shfrytëzohen vetëm për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit. Vendet në të cilat ndodhen mjetet për shuarjen e zjarrit, shënohen me shenja të dallueshme.

3. Aparatet, pajisjet dhe mjetet për shuarjen e zjarrit, si dhe pajisjet dhe instalimet për sinjalizimin dhe lajmërimin e zjarrit, mbahen në gjendje të rregullt dhe për to mbahet evidencë e rregullt.
4. Kontrollimi i pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit, si dhe pajisjet dhe instalimet për sinjalizimin dhe lajmërimin automatik të zjarrit, duhet të bëhet çdo tre muaj.

KREU III

ORGANIZIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 8

1. Kryetari i Komunës në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj përcakton politikën mbrojtëse nga zjarri, si dhe mbrojtjen e punëtorëve dhe të pasurisë, si vijon:
 - 1.1 Nxjerr akte vendime dhe urdhëresa, plane dhe programe në të cilat rregullohet mbrojtja nga zjarri në objektet e komunës si dhe marrjen e masave mbrojtëse nga zjarri.
 - 1.2 Përcjell gjendjen e organizimit, si dhe avancimin e mbrojtjes kundër zjarrit;
 - 1.3 Shqyrton përmbajtjen e planit për mbrojtje nga zjarri së paku një herë në vit si dhe vlerësimin e përputhshmërisë së këtij plani me planin zhvillimor të komunës.
 - 1.4 Nxjerrë akte tjera për mbrojtjen nga zjarri në objektet e komunës.

Neni 9

1. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka këto të drejta dhe detyra:
 - 1.1 Kujdeset për zbatimin e vendimeve dhe akteve nga neni 9 për mbrojtje nga zjarri.
 - 1.2 Kujdeset për furnizim me mjete teknike dhe mjete të nevojshme për mbrojtjen dhe shuarjen e zjarrit;
 - 1.3 Kujdeset për zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri;
 - 1.4 Ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për montimin, rregullimin e aparateve për mbrojtjen kundër zjarrit;
 - 1.5 Është përgjegjës për zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri para planifikimit të ndërtimit, rikonstruimit ose adaptimit të objektit;
 - 1.6 Kryen edhe punë tjera të cilat janë të përcaktuara me këtë rregullore, dispozitat e akteve të Komunës dhe ligjeve në fuqi.

Neni 10

1. Në kuadër të zbatimit të masave mbrojtëse nga zjarri, të gjithë drejtorët e drejtorive e kanë detyrë dhe përgjegjësi të:

- 1.1 Kontrollon organizimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri të caktuara me këtë rregullore;
- 1.2 Mënjanimin e rrezikut i cili mund të paraqitet nëse vet e ka shkaktuar zjarrin ose nga ana e punëtorëve apo personit të tretë në kuadër të drejtorisë së tij;
- 1.3 Organizon njohjen e punëtorëve me rrezikun nga zjarri dhe masat mbrojtëse si dhe reagimin në rast zjarri;
- 1.4 Kujdeset për furnizim me mjete teknike dhe mjete të nevojshme për mbrojtjen dhe shuarjen e zjarrit;
- 1.5 Lajmëron drejtorin për emergjencë në kuadër të komunës për marrjen e masave urgjente të mbrojtjes nga zjarri, në rast se punonjësit e drejtorisë nuk janë në gjendje që vet me sukses të ndërmarrin masa për shuarjen e zjarrit;
- 1.6 Merr pjesë në veprimet e shuarjes së zjarrit, shpëtimin e njerëzve të rrezikuar dhe pasurisë deri në momentin e ndërmarrjes së veprimeve nga ana e zjarrfikësve;
- 1.9 Kryen edhe punë tjera nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri të cilat janë të përcaktuara me këtë rregullore, dispozitat e akteve ligjore të Komunës dhe ligjeve në fuqi

Neni 11

Përgjegjësi për mbrojtje nga zjarri

1. Përgjegjësi për mbrojtjen nga zjarri në komunë është përgjegjës:

- 1.1 Për mbikëqyrjen e aprovimit të masave të caktuara të mbrojtjes nga zjarri;
- 1.2 Bënë analiza dhe raporton mbi gjendjen dhe problemet e mbrojtjes nga zjarri, si dhe organizimin dhe përgatitjen teknike;
- 1.3 Jep udhëzime më të afërta, vërejtje për objekte në bazë të specifikacionit në lidhje me rrezikun e zjarrit, mënyrën e mbrojtjes, si dhe veprimin në rast zjarri;
- 1.4 Organizon dhe kujdeset për evidencën e rregullt të pajisjeve të mbrojtjes kundër zjarrit;
- 1.5 Përcakton kushtet nën të cilat mund të shfrytëzohen pajisjet për shuarjen e zjarrit, aparatet për saldim dhe pajisjet tjera që punojnë me lëndë djegëse dhe gazrave djegëse, si dhe merr masa për largimin e tyre në vende të caktuara;
- 1.6 Në marrëveshje me drejtorët e drejtorive organizon aftësimin profesional të punëtorëve të punësuar nga lëmia e mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes kundër zjarrit;
- 1.7 Kontrollon nevojat dhe propozon furnizimin me pajisje adekuate, përgatitje dhe mjete për evitimin e zjarrit, lajmërimin dhe shuarjen e zjarrit në mënyrë efikase;
- 1.8 Mbanë evidencën e punëtorëve të cilët kanë kryer kurse nga mbrojtja kundër zjarrit, si dhe punëtorët të cilët janë të detyruar të intervenojnë në rast rreziku nga zjarri;
- 1.9 Kryen edhe punë tjera të cilat janë të rregulluara me akte ligjore.

Neni 12

Detyrat e punëtorëve për mbrojtje nga zjarri

1. Të gjithë stafi i komunës duhet:

- 1.1 Të njoftohet me rrezikun nga zjarri dhe ti zbatojnë masat e mbrojtjes kundër zjarrit sipas kësaj rregullore;
- 1.2 Të kujdeset për rregullsinë dhe përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit dhe mjeteve që janë të dedikuara për fikjen e zjarrit
- 1.3 Të evitojnë rrezikun i cili mund të jetë si shkaktarë i zjarrit ose të ndonjë fatkeqësie tjetër;
- 1.4 Të gjitha prishjet dhe dëmtimet në pajisjet elektrike, instalimet dhe pajisjet tjera prej të cilave mund të rrezikohet siguria e objektit dhe pasurisë së komunës, të lajmëroj menjëherë shërbimin profesional për të marr masa për largimin e tyre;
- 1.5 Në rast të paraqitjes së zjarrit ka për detyrë urgjentisht të lajmëron njësinë e zjarrfikësve dhe menjëherë të ndërmarrin masat e nevojshme për shuarjen e zjarrit.

Neni 13

Punëtori përgjegjës për mbrojtje nga zjarri ka për detyrë që secilin punëtor të ri që fillon punën në Komunë ta njoftojë me masat në rast të rrezikut nga zjarri, si dhe mënyrën si të mbrohet. Njoftimi bëhet me biseda individuale.

Neni 14

Me ardhjen njësisë së zjarrfikësve të gjithë punëtorët që gjenden në afërsi të zjarrit me lejen e drejtorit kanë për detyrë të vihen nën komandën e udhëheqësit të njësisë së zjarrfikësve dhe të zbatojnë urdhrat e tij.

Neni 15

1. Për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë, udhëheqësi i njësitit të zjarrfikësve ka të drejtë:

- 1.1 Të ndaloj qëndrimin në vendin ku është lajmëruar zjarri personave të cilët nuk marrin pjesë në shuarjen e zjarrit;
- 1.2 Urdhëron largimin e personave dhe materialin nga objekti i cili rrezikohet nga zjarri;
- 1.3 Urdhëron ndërprerjen e rrymës, gazit dhe burimeve tjera të energjisë
- 1.4 Të shfrytëzoj ujin nga të gjitha burimet,
- 1.5 Të rrënoj pjesërisht apo plotësisht objektet nga të cilët mund të përhapet zjarri, nëse përhapja tij nuk mund të evitohet në ndonjë mënyrë tjetër.
- 1.6 Të shfrytëzoj mjetet e tjera të transportit për bartjen e personave të lënduar nga vendi i ngjarjes deri në qendrën shëndetësore më të afërt.
- 1.7 Të shfrytëzoj të gjitha mjetet teknike dhe pajisjet tjera të nevojshme për kryerjen e operacionit.

Neni 16

Mënyra e kryerjes së kontrollit

Me kontrollë të brendshme të mbrojtjes nga zjarri nënkuptohet ndërmarrja e masave profesionale nga punëtorët e inkuadruar në Komunë sipas kësaj rregullore.

Neni 17

Për kryerjen e kontrollit punëtorët janë të detyruar që rregullisht të kryejnë kontrollë vizual të ambientit, rrethit të objektit, dhe të bashkëpunojnë me përgjegjësit e mbrojtjes nga zjarri dhe të lajmërojnë për masat e ndërmarra.

Neni 18

Përgjegjësia e punëtorëve për mos respektimin e masave mbrojtëse nga zjarri

Të gjithë punëtorët e Komunës janë përgjegjës për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kundër zjarrit të përshkruar me këtë rregullore dhe me ligj. Mosrespektimi dhe mos përmbajtja e masave kundër zjarrit konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës, për çka punëtorit mund ti shqiptohet masa disiplinore sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 19

1. Dispozitat e kësaj Rregullore vlejnë për punëtorët e Komunës në marrëdhënie të përhershme, punëtorëve me kohë të pacaktuar, si dhe të gjithë personave të cilët mund të ndodhen në hapësirat e objektit të komunës.
2. Në të gjitha rastet kur kërkohet një veprim për mbrojtje nga zjarri kërkohet vendimi i Kryetarit të Komunës.

Neni 20

Zbatimi

Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje është Kryetari i Komunës, i cili sipas nevojës dhe kërkesës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës raporton për zbatimin e saj.

Neni 21

Ndryshimi dhe Plotësimi

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregullore bëhen në harmoni me Ligjin për mbrojtjen nga zjarri dhe ligjeve tjera në fuqi.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe shpalljes në tabelën e shpalljeve.